Kronikë

# Durrës/ Shpërthimi me telekomandë mjetit të Aldi Mustafës, hakmarrja për një plagosje, pistë hetimi! Merren në pyetje 8 persona

*Ende nuk ka asnjë gjurmë nga autori/ët e atentatit ndaj Aldi Mustafës një ditë më parë në Shkozet të Durrësit. Blutë e Durrësit po punojnë ende për zbardhjen e ngjarjes. Për këtë qëllim një grup pune po punon me kamerat e sigurisë të marra nga objektet rreth e rrotull vendit ku ndodhi shpërthimi.*

■ VIDEO e shpërthimit/ Atentat me tritol mikut të 'Rrumit të Shjakut' në Shkozet, makina shpërthen në lëvizje! Aldi Mustafa del me gërvishtje të lehta, po udhëtonte vetëm në automjet

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
4 Prill, 10:58 | **Përditesimi: 4 Prill, 12:34**

**DURRËS**- Ende nuk ka asnjë gjurmë nga autori/ët e atentatit ndaj Aldi Mustafës një ditë më parë në Shkozet të Durrësit. Blutë e Durrësit po punojnë ende për zbardhjen e ngjarjes. Për këtë qëllim një grup pune po punon me kamerat e sigurisë të marra nga objektet rreth e rrotull vendit ku ndodhi shpërthimi.

Ndërkohë, gjatë ditës së djeshme dhe gjatë natës janë pyetur 8 persona në cilësinë e dëshmitarëve për të hedhur dritë mbi këtë ngjarje. Është konkluduar se shpërthimi është realizuar me telekomandim në distancë. Deri më tani nuk ka asnjë të ndaluar apo të shoqëruar.

LEXO EDHE:
**Meta nga Durrësi: Do i japim fund modelit të bashkisë si model kriminal! PS mbyt njerëzit me gjoba që t'i mbajë nën presion**

Aldi Mustafa në dëshminë e dhënë ditën e djeshme ka deklaruar se nuk ka konflikte me njeri dhe nuk ka një ide se cili mund të jetë personi që i ka vënë lëndën plasëse në makinë. Në polici bëjnë të ditur se po hetojnë një pistë në vitin e largët 2001 kur ai ka kryer një plagosje në zonën e plazhit.

***Si ndodhi ngjarja?***

***Atentati*** u regjistrua në orën 13:56, një ditë më parë në Shkozet të Durrësit. Mjetit me të cilin po udhëtonte Aldi Mustafa, një person me precedent të theksuar kriminal, pjesë e grupit të 'Rrumit të Shjakut', iu vendos një sasi i vogël tritoli në gomën e pasme. Tritoli shpërtheu teksa Mustafa ishte në lëvizje me mjetin tip 'Golf'. 37-vjeçari doli i pa lënduar nga shpërthimi ndërsa pak minuta para se të ndodhte ngjarja, la në banesë gruan me fëmijën.

***Kush është Aldi Mustafa?***

Aldi Mustafa, 37-vjeçar, njihet si një person me precedentë penal. Ai është arrestuar më 30 gusht të 2021 me dy të tjerë, pasi po planifikonin një vrasje. Aldi Mustafa rezulton i dënuar më parë me 10 vite burg në Gjermani, për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Ndërkohë më 30 dhjetor të vitit të kaluar, me vendim të gjykatës i është shuar masa e arrestit me kërkesë të tij. Ai ishte dënuar me 2 vjet burgim pas arrestimit në gusht 2021 për mosbindje të urdhrit të policisë, armëmbajtje pa leje dhe drejtim të parregullt të mjetit.

Mustafa më herët ka qenë anëtar i një bande të njohur në Durrës, ndërsa kohët e fundit ka pasur lidhje me Aleksandër Lahon i njohur si 'Rrumi', një personazh i përfolur në ngjarje kriminale, siç ishte dhe atentati ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja.

SI.E./r.k./Shqiptarja.com

**TAG:** Durres | Aldi Mustafa | atentat me tritol | policia e durresit | aleksander laho

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Mendoni se për komandantët e UÇK do të bëhet drejtësi në Hagë?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Ilir Gjinali emërohet drejtori i ri i Kadastrës në Durrës
3 Prill, 16:29

VIDEO e shpërthimit/ Atentat me tritol mikut të 'Rrumit të Shjakut' në Shkozet, makina shpërthen në lëvizje! Aldi Mustafa del me gërvishtje të lehta, po udhëtonte vetëm në automjet
3 Prill, 14:16

Thyente xhamat e makinave dhe vidhte laptopë e shuma parash brenda tyre, arrestohet autori i 5 grabitjeve në Durrës (EMRI)
3 Prill, 12:41

Durrës, përplasën motorin në Manzë ku vdiq pasagjeri, në pranga 3 persona
3 Prill, 12:00

U kap me kallashnikov dhe 30 fishekë, arrestohet 17 vjeçari në Krujë
3 Prill, 11:45

Durrës, makina përplas motorin, humb jetën pasagjeri që ishte në motor! Shoferi i makinës që përplasi motori ka ikur nga vendngjarja (VIDEO)
2 Prill, 21:46

U dëmtua nga tërmeti, mbeten pezull punimet në Teqenë e Dollmës në Kalanë e Krujës, firma u tërhoq

Julian Shota

31 Mars, 18:40

Pikë e re për kontrollin e ushqimeve në Portin e Durrësit! Krifca inspektim me ministrin italian Lollobrigida: Do kalojnë 1.4 mln tonë produkte në vit
31 Mars, 17:33

PAMJE të rënda/ Aksident në Manëz të Durrësit, makina përfundon në kanal! 4 të plagosur transportohen drejt spitalit
31 Mars, 16:24

Ç'po ndodh me kandidatët e PD për 14 Majin? Alibeajt i ikën një tjetër garues për kryetar bashkie, tërhiqet Sabah Sheta i Krujës! Ende 14 emra në garë
30 Mars, 11:24

Me armë zjarri pa leje, arrestohen babë e bir në Shijak
29 Mars, 11:09

Peshëngritje/ Botërori i të rinjve në Durrës, Enkileda Carja i dhuron 2 medalje Shqipërisë
29 Mars, 09:53



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje